

VENDIM
Nr.915, datë 28.12.2011

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË VITIT 2012 PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE
PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të vitit 2012 për menaxhimin e shpenzimeve publike, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Integritetit, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, si dhe fondet speciale të tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha